



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/43/21

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga Y.Xh, ndaj gjyqtares L.B, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 14.12.2021 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga Y.Xh, ndaj gjyqtares L.B, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për të parashtruar Kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Autoriteti Kompetent i kësaj Gjykate - Kryetarja e Gjykatës A.Sh R me datë 22.11.2021 nga av. Y.Xh, ka pranuar ankesën ndaj gjyqtares L.B, me propozim që ankesa të aprovohet dhe për shkelje disiplinore ti shqiptohet masa disiplinore vërejtje publike.

Avokati Y.Xh, në ankesën e parashtruar ka theksuar çështjen e propozimit për ndryshim të padisë dhe mos pajtimin lidhur me nxjerrjen e aktvendimit nga gjykata, që sipas palës bazuar në dispozitat e LPK-së konsiderohet se ekziston pëlqimi i të paditurve për ndryshimin e padisë, po që se i padituri fillon të merr pjesë në shqyrtimin e çështjes sipas padisë së ndryshuar, pa e kundërshtuar më parë ndryshimin. Gjyqtarja shprehet në kundërshtim me autorizimin të cilin e jep LPK-ja meqenëse parakusht është vetëm pëlqimi i të paditurve.

Po ashtu, sipas parashtruesit gjyqtarja refuzon propozimin për ndryshimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv, pa një vendim të arsyetuar dhe në kundërshtim me parimin e barazisë së palëve, duke mos dhënë këshillën juridike për të apeluar. Më tutje në ankesë janë theksuar edhe çështjet tjera lidhur me zbatimin apo moszbatimin e dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontesimore në çështjen e ndryshimit të padisë.

Në lidhje me pretendimet e theksuar në ankesë, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se, “Procedura në kontestet për shkak të pengim posedimit bënë pjesë në grupin e procedurave të veçanta kontestimore, ku për shkak të natyrës së këtyre kontesteve, në masë të caktuar bëhet shmangie nga rregullat e përgjithshme të procedurës kontestimore. Për shkak të natyrës specifike të kontesteve të kësaj natyre, Gjykata duhet të veproj me prioritet në procedimin e tyre. Në procedimin e këtyre padive nuk zbatohen dispozitat që kanë të bëjnë me ndryshimin e padisë dhe atë nga neni 257 deri në nenin 260 të LPK-së, kjo për shkak se nuk lejohet ndryshimi i padisë fillimisht të ushtruar për shkak të pengim posedimit në një bazë tjetër. Pala ankuese më pas ka cituar nenin 258 paragrafi 5 të LPK-së sipas të cilit parashihet se, kundër aktvendimit me të cilin lejohet apo refuzohet ndryshimi i padisë nuk lejohet ankim i veçantë. Vet ankuesi nuk e ka të qartë se çfarë kërkon, derisa thirret në mos dhënien e këshillës juridike, pra, mohimin e së drejtës për ankesë të veçantë, i njëjti në po të njëjtën ankesë i referohet dispozitës ligjore në të cilën nuk lejohet ankesë e veçantë në vendimet e marra procedurale sipas propozimit për ndryshimin e padisë.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të ankesës, dhe deklarimit të gjyqtares, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për shkelje disiplinore të gjyqtares L.B.

Autoriteti i kësaj gjykate, pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës, shkresave të lëndës dhe deklarimit të gjyqtares ka vlerësuar se çështjet e parashtruara në ankesë lidhur me pretendimet për shkelje disiplinore nuk kanë bazë të arsyeshme, për shkak se pretendimet e parashtruar kanë të bëjë me çështje procedurale.

Referuar procesverbalit të seancës përgatitore të datës 17.11.2021, lidhur me propozimin e autorizuarit të paditësve për ndryshimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv, gjykata me aktvendim ka refuzuar propozimin për ndryshimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv dhe në të njëjtin aktvendim në pikën II ka përcaktuar: “arsyetimin lidhur me këtë vendim gjykata do ta jap në vendimin përfundimtar”. Është bindje e lirë e gjyqtares për të vendosur çështjen, e cila funksionin e saj e ushtron në mënyrë të pavarur, bazuar në Kushtetutë, ligj dhe vlerësim individual të fakteve.

Për çështjen e pretendimeve për mohimin e përdorimit të mjeteve juridike është cekur në paragrafin e katër (4) të arsyetimit në njërën anë, ndërsa në anën tjetër në paragrafin e gjashtë (6) të të njëjtës ka theksuar, ...kundër aktvendimit të tillë për lejimin ose refuzimin e ndryshimit të padisë nuk lejohet ankesë e veçantë. Ndaj vendimit përfundimtar të kësaj gjykatës pala e pakënaqur, sipas autorizimit, ka të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike në instancën e gjykatës më të lartë.

Në bazë të fakteve për këto çështje dhe provave të shqyrtuar nga Autoriteti i kësaj gjykate, veprimet e gjyqtares nuk përbëjnë shkelje disiplinore, dhe nuk ka shkelje të dispozitave të nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve apo shkelje të Kodit të Etikës Profesional për Gjyqtarë.

Andaj, Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me parashtesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkuara më lartë vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar KGJK-së kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
AD/GJTHPR/43/21, më datë 14.12.2021

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë